



British Embassy
Pristina



Memorandum Mirëkuptimi

në mes të Ambasadës Britanike ne Prishtine Komunës se Prizrenit Dhe EC Ma Ndryshe

Komuna e Prizrenit dhe EC Ma Ndryshe, janë pajtuar që të fillojnë bashkëpunimin për projektin e titulluar “Transparenca online e komunës së Prizrenit” më tutje: “Projekt”, me përkrahje të Ambasadës Britanike ne Prishtine.

1. Detajet janë të rregulluara me Marrëveshjen Llogaridhënëse për Grant për Projektin dhe qëllimin e bashkëpunimit teknik, të cilat janë të parashtruara në “Projekt”, të bashkëngjitura me këtë marrëveshje.
2. Projektin do të zbatohet nga EC MA Ndryshe, organizatë jo-qeveritare me seli në Prizren. Komuna e Prizrenit, Rr. Ismet J Kumanova Nr. 31
3. Komuna e Prizrenit dhe EC Ma Ndryshe, përmes këtij Memorandumi të Mirëkuptimit të garantuar nga Ambasada Britanike në Prishtinë, zotohen në marrjen e këtyre obligimeve

Obligimet e Komunës së Prizrenit

Komuna e Prizrenit, respektivisht Kryetari i Komunës dhe ekzekutivi (drejtoritë komunale) për zbatim sa më efektiv të projektit, zotohen se:

- Do të jenë partnerë strategjik në zbatimin e projektit, duke vepruar në transparencë të plotë dhe bashkëpunim të ngushtë me organizatën monitoruese,
- Monitoruesve të organizatës do t’u ofrojnë qasje të papenguar në të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike,
- Monitoruesve të organizatës do t’u ofrojnë qasje fizike në hapësirat e administratës komunale,
- Monitoruesve të organizatës do t’u ofrojnë qasje të papenguar në takimet e hapura të organeve të komunës (Komitetet e Kuvendit të Komunës, seancat plenare të Kuvendit të Komunës, etj.)

Obligimet e zbatuesit


EC Ma Ndryshe do t’i zbatojë të gjitha aktivitetet e specifikuar në “Projekt”. EC Ma Ndryshe do të monitorojë punën e organeve komunale në Prizren, me fokus të veçantë në degën e ekzekutivit (Kryetari i komunës dhe drejtorët).

EC Ma Ndryshe për zbatim sa më efektiv të projektit, zotohet se:

- Do ta realizojë monitorimin e komunës me standarde të larta profesionale dhe hulumtuese, të bazuara në fakte
- Do të sigurojë dialog të përhershëm me organet dhe zyrtarët komunalë për të gjitha çështjet e monitoruara (hulumtuara), dhe do të gjejnë zgjidhje të përbashkët



British Embassy
Pristina



- Do të sigurojë edhe mendimin e zyrtarëve përkatës komunalë në lidhje me çështjet e monitoruara, para se ato të publikohen në media
 - Të gjitha të gjeturat e monitorimit do t'i përkthejë edhe në gjuhët rekomanduese me qëllim të përmirësimit të performancës qeverisëse në Prizren,
4. Projekti fillon më 1 shtator 2012 dhe përfundon më 31 Mars 2013. Të gjitha palët do të konsiderojnë vazhdimin e këtij projekti në fazën e fundit të implementimit të tij.
 5. Nëse ndodh ndonjë ndryshim që sipas mendimit të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ose Komunes së Prizrenit dëmtojnë ndjeshëm vlerën e projektit, palët paraprakisht do të konsultohen për masat për ta zgjidhur problemin dhe të pajtohen për veprimet e mëtejme. Në rast të ndryshimeve përmbajtjesore, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar rezervon të drejtën për ta përfunduar kontributin e saj në këtë Projekt.
 6. Të gjitha korrespondencat lidhur me këtë Memorandum dhe projektin do t'i drejtohen: Ymer Berisha, Shef i Zyrës për Komunikim dhe Informim dhe Këshilltar Profesional i Kryetarit, komuna e Prizrenit; Hajrulla Çeku, Drejtor Ekzekutiv, EC ma Ndryshe në koordinim me Miranda Shala, Zyrtare për Projekte, Ambasada Britanike Prishtine.
 7. Nëse pikat e lartpërmendura dhe në Marrëveshja Llogaridhënëse për Grant dhe Projekti të bashkangjitura janë të pranueshme për Komunën e Prizrenit dhe Ec Ma Ndryshe. Ky Memorandum do ta konsiderojë marrëveshjen të konfirmuar të palëve nënshkruese mbi këtë çështje.

Konfirmuar nga:

Për Ambasadën Britanike

Ian Cliff
Ambasador

Për Komunën e Prizrenit

Ramadan Muja
Kryetar

Për EC Ma Ndryshe

Hajrulla Çeku
Drejtor ekzekutiv

Prizren, Shtator 2012